



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5180 Prot.

Roskovec, më 24, 12 2018

VENDIM

NR 103. DATË 19.12. 2018

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.93 DATË 19.11.2018 "PËR MIRATIMIN E  
PAKETËS FISKALE PËR VITIN 2019"**

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar dhe ligjit Nr.142/2015 datë 17.12.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore", të ndryshuar, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI:**

- Miratimin e një ndryshimi në vendimin Nr. 93 datë 19.11.2018 "Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2019" Kapitulli I-Taksat Vendore, pika 1.3 "Taksa për zënien e hapësirave publike" është shfuqizuar në mbështetje të ligjit nr. 142/2015 datë 17.12.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar:
- Në referim të ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, kreu VII "Tarifat vendore dhe administrimi i tyre", Neni 35 :*Tarifat vendore dhe administrimi i tyre*", Pika c) *paguhet për zënien e hapësirave publike për qëllime biznesi. Tarifa llogaritet si detyrim mujor i tatimpaguesit. Këshilli Bashkiak vendos për nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e kësaj tarife, si dhe mund të caktojë nivele të ndryshme të kësaj tarife, sipas nivelit të zhvillimit të veprimtarisë të biznesit në zona të ndryshme të qendrës së banuar.*



*Tarifa për zënien e hapësirës publike nuk zbatohet për hapësirat që nuk janë në pronësi dhe nën administrimin e pushtetit vendor.*

➤ **Niveli tregues i tarifës së zënies së hapësirës publike (tarifë tregu)**

**Për Bashkinë e Roskovecit është 50 lekë/m<sup>2</sup>**

Shënim: Për njësitë administrative të tjera, niveli tregues i taksës është sa një e dyta e nivelit tregues përkatës.

**KRYETAR**

**Eleni Goga**

